

Data 16.07.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim për konceptimin dhe dizajnimin e identitetit vizual, sistemit të komunikimit, platformës digjitale dhe sinjalistikës së Galerisë Kombëtare të Arteve.”

Loti 1: Konceptimi dhe dizajnimi i identitetit vizual, dizajnit të websitit, sistemit të komunikimit institucional, dizajnit editorial dhe sinjalistikës/wayfinding për Galerinë Kombëtare të Arteve.

Loti 2: Zhvillimi teknik (programim) i platformës website, CMS dhe implementimi teknik i komunikimit digjital për Galerinë Kombëtare të Arteve.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT :

79822500-7 Shërbime të dizajnit grafik

92521000-9 Shërbime muzeu

72413000-8 Shërbimet e projektimit të faqeve për world wide web (www)

92312000-1 Shërbime artistike

Fondi limit i procedurës: 9,695,794 (nëntë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH.**

Loti 1: 8,617,242 (tetë milionë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e dy) **Lekë Pa TVSH**

Loti 2: 1,078,552 (një milion e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) **Lekë Pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, i ndryshuar, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Autoriteti/enti kontraktor “**Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a**” ka hartuar procesverbalin të kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI 1: Konceptimi dhe dizajnimi i identitetit vizual, dizajnit të websitit, sistemit të komunikimit institucional, dizajnit editorial dhe sinjalistikës/wayfinding për galerinë kombëtare të arteve.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të kontratës. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedure prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion të paktën:

a) 1 (një) Menaxher Projekti/ Drejtor Kreativ dhe Artistik

- a) të ketë përfunduar arsimin e lartë në dizajn, komunikim vizual, arte pamore ose fusha të ngjashme;

b) 1 (një) Dizajner Grafik/Artistik

- të ketë përfunduar arsimin e lartë në dizajn grafik, komunikim vizual, arte pamore, multimedia ose fusha të ngjashme;

Për secilin anëtar të stafit duhet të paraqiten:

- Diploma;
- Kontrata e punës e vlefshme.
- CV

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 2 dhe pika 4, shkronjat “b” dhe “c”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, kriteri është përcaktuar me qëllim garantimin e disponimit nga operatori ekonomik të personelit kryesor, të kualifikuar dhe të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa për një Menaxher Projekti/Drejtor Kreativ dhe Artistik, me arsim të lartë në dizajn, komunikim vizual, arte pamore ose fusha të ngjashme, lidhet me nevojën për planifikimin, organizimin, koordinimin dhe ndjekjen e të gjithë procesit të realizimit të shërbimit, si dhe garantimin e koherencës artistike dhe vizuale të zgjidhjeve që do të zhvillohen. Kërkesa për një Dizajner Grafik/Artistik, me arsim të lartë në dizajn grafik, komunikim vizual, arte pamore, multimedia ose fusha të ngjashme, është përcaktuar në funksion të realizimit profesional të identitetit vizual, sistemit të komunikimit dhe elementeve grafike e artistike të parashikuara në termat e referencës dhe specifikimet teknike. Këto profile janë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën dhe komponentët e shërbimit dhe janë të nevojshme për të garantuar realizimin cilësor dhe të koordinuar të kontratës. Diploma shërben për verifikimin e formimit përkatës profesional, CV-ja për evidentimin e profilin dhe të dhënave profesionale të specialistit, ndërsa kontrata e vlefshme e punës provon marrëdhënien dhe disponueshmërinë e tij për realizimin e kontratës. Kriteri mbështetet gjithashtu në Raportin Përfundimtar të Rishikuar nr. 34/34 prot., datë 06.07.2026, me objekt “Rishikimi i termave të referencës, specifikimeve teknike, përllogaritjes së fondit limit dhe strukturimi i procedurës në lote”, të hartuar nga Galeria Kombëtare e Arteve, në cilësinë e institucionit përfitues dhe hartues të termave të referencës dhe specifikimeve teknike, në të cilin janë përcaktuar profilet e personelit të nevojshëm për realizimin e shërbimit.

Për Lot 1:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

PËR LOTIN 1

A) ¹Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

- | | |
|---|---------|
| - Çmimi | 75 pikë |
| - Eksperienca dhe kualifikimi i ekipit të projektit | 20 pikë |
| - Metodologjia e punës dhe konceptimi fillestar | 5 pikë |

1. Çmimi: 75 pikë

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

2- Eksperienca dhe kualifikimi i ekipit të projektit 20 pikë

- **Eksperienca dhe kualifikimi i Menaxherit të Projektit/ Drejtor Kreativ dhe Artistik.**
- **të ketë të paktën 5 (pesë) vite përvojë profesionale. 5 pike**

Argumentimi: Kërkesa për të paktën 5 (pesë) vite përvojë profesionale është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën dhe kompleksitetin e shërbimit, si dhe përgjegjësitë që lidhen me planifikimin, organizimin, koordinimin dhe ndjekjen e realizimit të projektit.

Periudha prej 5 (pesë) vitesh është vlerësuar si një prag i arsyeshëm dhe proporcional, i nevojshëm për të dëshmuar se specialisti ka fituar përvojë të konsoliduar në fazat e ndryshme të realizimit të projekteve, nga konceptimi dhe planifikimi fillestar deri te zhvillimi, koordinimi, rishikimi dhe implementimi përfundimtar.

Përvoja më e gjatë profesionale përbën një element cilësor që mund të ndikojë pozitivisht në organizimin, koordinimin dhe realizimin e kontratës dhe, për këtë arsye, vlerësohet me pikë në mënyrë proporcionale.

¹ Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: Ofertuesi që paraqet dhe provon Menaxherin e Projektit/Drejtorin Kreativ dhe Artistik me numrin më të lartë të viteve të përvojës profesionale përfiton 5 (pesë) pikë, ndërsa ofertuesit e tjerë vlerësohen proporcionalisht.

Në rast se përvoja profesionale e specialistit të propozuar është më pak se 5 (pesë) vite, ofertuesi nuk përfiton pikë për këtë nënkriter.

Metoda e verifikimit: Përvoja profesionale do të verifikohet nëpërmjet CV-së, librezës së punës, deklaratës individuale të kontributeve të sigurimeve shoqërore, kontratave të punës ose të shërbimit, vërtetimeve nga punëdhënësit apo porositësit ose dokumenteve të tjera të barasvlershme. Dokumentacioni duhet të evidentojë periudhën e angazhimit, pozicionin dhe fushën e veprimtarisë së specialistit.

Periudhat e angazhimit që mbivendosen në kohë do të përlllogariten vetëm një herë.

Dokumentet për verifikim:

Për verifikimin e përvojës profesionale të Menaxherit të Projektit, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme.
- CV-në

Periudhat e angazhimit që mbivendosen në kohë do të përlllogariten vetëm një herë.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_k = \frac{O_k \times P_{\max k}}{V_{\max k}}$$

$V_{\max k}$ _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{\max k}$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_k _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

- **Pjesëmarrja e Menaxherit të Projektit/Drejtori Kreativ dhe Artistik në projekte të ngjashme në fushën e dizajnit, identitetit vizual ose komunikimit artistik. 5 pikë**

Argumentimi: Vlerësimi i numrit të projekteve të ngjashme në të cilat ka marrë pjesë Menaxheri i Projektit/Drejtori Kreativ dhe Artistik është përcaktuar duke marrë në konsideratë ndikimin e përvojës praktike të këtij specialisti në cilësinë e realizimit të shërbimit. Pjesëmarrja në projekte në fushën e dizajnit, identitetit vizual ose komunikimit artistik dëshmon aftësinë për të drejtuar procesin krijues, për të koordinuar komponentët e projektit dhe për të garantuar koherencën e zgjidhjeve të propozuara.

Kriteri nuk përcakton një numër minimal projektesh, por vlerëson në mënyrë proporcionale përvojën e provuar të secilit specialist. Numri më i lartë i projekteve përbën një avantazh cilësor

dhe mundëson diferencimin objektiv të ofertave, duke i dhënë më shumë pikë ofertës që paraqet një specialist me përvojë më të gjerë në projekte të ngjashme.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: ofertuesi që paraqet dhe provon numrin më të lartë të projekteve të ngjashme përfiton 5 (pesë) pikë, ndërsa ofertuesit e tjerë përfitojnë pikë në raport proporcional me numrin e projekteve të ngjashme të paraqitura dhe të provuara prej tyre.

Metoda e verifikimit: Numri i projekteve të ngjashme do të verifikohet nëpërmjet portofolit profesional, kontratave, vërtetimeve, referencave, certifikatave të realizimit ose dokumenteve të tjera të barasvlershme. Për secilin projekt duhet të evidentohen objekti ose përshkrimi, fusha, periudha e realizimit dhe roli i Menaxherit të Projektit/Drejtorit Kreativ dhe Artistik. Projektet për të cilat nuk provohet qartë pjesëmarrja e specialistit nuk do të përfshihen në përllogaritjen e pikëve.

Dokumentet për verifikim:

Për verifikimin e projekteve të ngjashme, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- portofolin profesional;
- kontrata, vërtetime, referenca nga punëdhënësit ose porositësit, certifikata realizimi, dokumente pranimi.

Për secilin projekt duhet të evidentohen emërtimi ose përshkrimi i projektit, fusha e tij, periudha e realizimit dhe roli i Menaxherit të Projektit/ Drejtorit Kreativ dhe Artistik. Projektet për të cilat nuk provohet qartë pjesëmarrja e specialistit nuk përfshihen në përllogaritjen e pikëve.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_k = \frac{O_k \times P_{\max k}}{V_{\max k}}$$

$V_{\max k}$ _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{\max k}$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_k _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

o Eksperiencia dhe kualifikimi i Dizajnerit Grafik/Artistik

b) të ketë të paktën 5 (pesë) vite përvojë profesionale; 5 pikë

Dizajneri Grafik/Artistik duhet të ketë të paktën 5 (pesë) vite përvojë profesionale në fushën e dizajnit grafik, identitetit vizual, komunikimit vizual, arteve pamore, multimedias ose në fusha të ngjashme.

Argumentimi: Kërkesa që Dizajneri Grafik/Artistik të ketë të paktën 5 (pesë) vite përvojë profesionale është përcaktuar në funksion të natyrës, kompleksitetit dhe rëndësisë institucionale të shërbimit. Kjo periudhë vlerësohet e nevojshme për të dëshmuar se specialisti ka fituar përvojë të konsoliduar dhe aftësi praktike në konceptimin dhe zhvillimin e identiteteve vizuale, sistemeve të komunikimit dhe elementeve grafike e artistike. Përvoja profesionale disavjeçare mundëson që specialisti të ketë njohuri të mjaftueshme mbi fazat e zhvillimit të një projekti, nga konceptimi fillestar dhe përpunimi i ideve deri te përshtatja dhe zbatimi i tyre në formate të ndryshme komunikimi. Minimumi prej 5 (pesë) vitesh është vlerësuar si një prag i arsyeshëm dhe proporcional për të dëshmuar përvojë të qëndrueshme dhe jo rastësore në këtë fushë.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: Ofertuesi që propozon Dizajnerin Grafik/Artistik me numrin më të lartë të viteve të përvojës profesionale përfiton 5 (pesë) pikë, ndërsa ofertuesit e tjerë vlerësohen proporcionalisht, sipas formulës së përcaktuar më poshtë. Në rast se përvoja profesionale e specialistit është më pak se 5 (pesë) vite, ofertuesi nuk përfiton pikë për këtë nënkriter.

Metoda e verifikimit: Përvoja profesionale e Dizajnerit Grafik/Artistik do të verifikohet nëpërmjet CV-së, librezës së punës, deklaratës individuale të kontributeve të sigurimeve shoqërore të lëshuar nga portali e-Albania ose dokumentacionit tjetër të barasvlershëm që vërteton periudhën, pozicionin dhe fushën e angazhimit profesional.

Dokumentet për verifikim:

Për verifikimin e përvojës profesionale të Dizajnerit Grafik/Artistik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme.
- CV-në e specialistit të propozuar;

Periudhat e angazhimit që mbivendosen në kohë do të përlllogariten vetëm një herë.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_k = \frac{O_k \times P_{\max k}}{V_{\max k}}$$

$V_{\max k}$ _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{\max k}$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_k _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

c) Pjesëmarrja e Dizajnerit Grafik/Artistik në projekte të ngjashme në fushën e dizajnit, identitetit vizual ose komunikimit artistik. 5 pikë

Argumentimi: Vlerësimi i numrit të projekteve të ngjashme në të cilat ka marrë pjesë Dizajneri Grafik/Artistik është përcaktuar duke marrë në konsideratë ndikimin e drejtpërdrejtë të përvojës praktike të

këtij specialisti në cilësinë e realizimit të shërbimit. Pjesëmarrja në projekte në fushën e dizajnit, identitetit vizual ose komunikimit artistik dëshmon aftësinë për të zhvilluar koncepte vizuale, për t'i përshtatur ato me karakterin institucional dhe për të ruajtur koherencën ndërmjet elementeve të ndryshme grafike.

Kriteri nuk përcakton një numër minimal projektesh, por vlerëson proporcionalisht përvojën e provuar të specialistit. Numri më i lartë i projekteve përbën një avantazh cilësor dhe mundëson diferencimin objektiv të ofertave, duke favorizuar ofertën që paraqet një Dizajner Grafik/Artistik me përvojë më të gjerë në projekte të ngjashme.

Vlerësohet numri i projekteve të ngjashme, të paraqitura dhe të provuara, në të cilat ka marrë pjesë Dizajneri Grafik/Artistik.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: ofertuesi që paraqet dhe provon numrin më të lartë të projekteve të ngjashme përfiton 5 (pesë) pikë, ndërsa ofertuesit e tjerë përfitojnë pikë në raport proporcional me numrin e projekteve të ngjashme të paraqitura dhe të provuara prej tyre.

Metoda e verifikimit: Numri i projekteve të ngjashme do të verifikohet nëpërmjet portofolit profesional, kontratave, vërtetimeve, referencave, certifikatave të realizimit ose dokumenteve të tjera të barasvlershme. Për secilin projekt duhet të evidentohen objekti ose përshkrimi, fusha, periudha e realizimit dhe roli i Dizajnerit Grafik/Artistik. Projektet për të cilat nuk provohet qartë pjesëmarrja e specialistit nuk do të përfshihen në përllogaritjen e pikëve.

Për verifikimin e projekteve të ngjashme, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- portofolin profesional;
- kontrata, vërtetime, referenca nga punëdhënësit ose porositësit, certifikata realizimi, dokumente pranimi.

Për secilin projekt duhet të evidentohen emërtimi ose përshkrimi i projektit, fusha e tij, periudha e realizimit dhe roli i Dizajnerit Grafik/Artistik. Projektet për të cilat nuk provohet qartë pjesëmarrja e specialistit nuk përfshihen në përllogaritjen e pikëve.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_k = \frac{O_k \times P_{\max k}}{V_{\max k}}$$

$V_{\max k}$ _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{\max k}$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_k _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

3. Metodologjia e punës dhe konceptimi fillestar

5 pikë

Argumentimi: Kriteri “Metodologjia e punës dhe konceptimi fillestar” është përcaktuar si kriter vlerësimi me pikë, pasi cilësia e realizimit të shërbimit nuk varet vetëm nga përvoja dhe kualifikimi i ekipit, por edhe nga mënyra se si operatori ekonomik kupton objektivat e projektit dhe propozon organizimin e procesit të punës.

Metodologjia e paraqitur mundëson vlerësimin e qasjes së operatorit ekonomik për organizimin e fazave të projektit, koordinimin me Galerinë Kombëtare të Arteve, zhvillimin dhe implementimin e identitetit vizual, si dhe garantimin e koherencës ndërmjet komponentëve të ndryshëm të shërbimit.

Konceptimi fillestar shërben për të vlerësuar aftësinë e operatorit ekonomik për të interpretuar karakterin institucional dhe artistik të Galerisë Kombëtare të Arteve dhe për ta përkthyer atë në drejtime të përshtatshme konceptuale dhe vizuale. Ky vlerësim nuk synon përzgjedhjen e një dizajni përfundimtar gjatë fazës së ofertimit, por evidentimin e nivelit të të kuptuarit të projektit, qartësisë së mendimit, koherencës së qasjes dhe zbatueshmërisë së propozimit.

Vendosja e këtij kriteri me pikë mundëson krahasimin cilësor dhe objektiv të ofertave të vlefshme, bazuar në elementet dhe nivelet e vlerësimit të përcaktuara paraprakisht në dokumentet e tenderit.

a) Metodologjia e punës – 2.5 pikë

Përshkrimi i mënyrës se si operatori ekonomik synon të përkthejë vlerat institucionale, kontekstin artistik dhe angazhimin e publikut në një identitet vizual koherent, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: qasjen metodologjike të propozuar, organizimin e fazave të projektit, qartësinë e procesit të zhvillimit dhe implementimit, si dhe mekanizmat e komunikimit dhe koordinimit me institucionin.

Elementet që do të vlerësohen:

- përkthimi i vlerave institucionale dhe kontekstit artistik në identitetin vizual;
- qasja për angazhimin e publikut;
- organizimi i fazave të projektit;
- qartësia e procesit të zhvillimit dhe implementimit;
- komunikimi dhe koordinimi me institucionin;
- zbatueshmëria e metodologjisë së propozuar.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

- Trajtim i plotë, i qartë, koherent dhe i zbatueshëm i të gjitha elementeve të kërkuara – **2.5 pikë**;
- Trajtim i pjesshëm i elementeve të kërkuara ose paraqitje me mangësi dhe paqartësi – **1.25 pikë**;
- Elementet nuk janë trajtuar ose propozimi nuk lidhet me kërkesat e objektivit – **0 pikë**.

b) Konceptimi fillestar – 2.5 pikë

Reflektimet fillestare mbi drejtimit e mundshme të dizajnit ose temat konceptuale, duke marrë në konsideratë rolin dhe identitetin e një galerie kombëtare në kontekstin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, përfshirë, por pa u kufizuar në: qartësinë dhe koherencën e qasjes konceptuale, përshtatshmërinë me karakterin institucional dhe artistik të Galerisë Kombëtare të Arteve, si dhe lidhjen e drejtimeve të propozuara me objektivat e projektit.

Elementet që do të vlerësohen:

- qartësia dhe koherenca e qasjes konceptuale;
- përshtatshmëria me karakterin institucional dhe artistik të Galerisë Kombëtare të Arteve;

- reflektimi i rolit të një galerie kombëtare në kontekstin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- lidhja e drejtimeve të propozuara me objektivat e projektit;
- zbatueshmëria e drejtimeve fillestare të dizajnit.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

- Qasje konceptuale e qartë, koherente, e argumentuar dhe e lidhur plotësisht me karakterin dhe objektivat e institucionit – **2.5 pikë**;
- Qasje konceptuale e trajtuar pjesërisht, e përgjithshme ose me mangësi në lidhjen me objektivat e projektit – **1.25 pikë**;
- Qasja konceptuale nuk është trajtuar ose nuk lidhet me objektin e prokurimit – **0 pikë**.

Metoda e verifikimit: Vlerësimi për nënkriteret **a)** dhe **b)** do të kryhet mbi bazën e propozimit konceptual/planit të punës të paraqitur nga operatori ekonomik. Vlerësimi për secilin nënkriter do të mbështetet vetëm në elementet dhe nivelet e vlerësimit të përcaktuara më sipër dhe do të pasqyrohet e arsyetohet në procesverbalin e vlerësimit. Pikët e përfituara për të dy nënkriteret do të mbledhen, ndërsa vlerësimi maksimal për këtë kriter nuk mund të tejkalojë 5 (pesë) pikë.

Formati dhe mënyra e dorëzimit

- **Gjatësia:** jo më shumë se 2 (dy) faqe;
- **Gjuha:** shqip ose anglisht;
- **Formati:** tekst i vazhdueshëm; nuk kërkohet paraqitja e imazheve, skicave apo materialeve të tjera vizuale;
- **Originaliteti:** propozimi duhet të jetë origjinal dhe i hartuar posaçërisht për këtë procedurë prokurimi.

Vlerësimi për pikat a) dhe b) do të bëhet me rend rritës, si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_k = \frac{O_k \times P_{\max k}}{V_{\max k}}$$

$V_{\max k}$ _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{\max k}$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_k _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

LOTI 2: Zhvillimi teknik (programim) i platformës website, CMS dhe implementimi teknik i komunikimit digjital për Galerinë Kombëtare të Arteve.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të kontratës. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë:

Certifikatë të vlefshme SSH EN ISO/IEC 27001 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, me objekt certifikimi në përputhje me natyrën e shërbimeve objekt prokurimi.

Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1, shkronja “c”, dhe nenin 79 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 44 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Standardi SSH EN ISO/IEC 27001:2023 “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, ose ekuivalent, është i nevojshëm për të dëshmuar se operatori ekonomik zbaton masa dhe procedura të strukturuar për administrimin e sigurisë së informacionit gjatë zhvillimit të platformës website dhe sistemit CMS. Zbatimi i këtij standardi kontribuon në mbrojtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit, administrimin e rreziqeve të sigurisë dhe realizimin e shërbimit në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë një ekip minimal për realizimin e kontratës, të përbërë nga specialistët e mëposhtëm:

- a) Të paktën 1 (një) Programues/Web Developer, me arsim të lartë në një nga profilet e mëposhtme:
- Informatikë, Teknologji Informacioni, Inxhinieri Informatike, Inxhinieri Telekomunikacioni ose në një profil tjetër të ngjashëm apo ekuivalent.
 - Diploma;
 - CV-ja, ku të evidentohet arsimi dhe eksperiencia profesionale përkatëse.
 - Kontrata e punës e vlefshme.

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 2 dhe pika 4, shkronjat “b” dhe “c”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, kriteri është përcaktuar për të garantuar disponimin e personelit teknik të kualifikuar dhe të nevojshëm për realizimin e kontratës.

Kërkesa për të paktën 1 (një) Programues/Web Developer lidhet drejtpërdrejt me komponentët teknikë të shërbimit, të cilët përfshijnë zhvillimin frontend dhe backend të platformës, konfigurimin e sistemit CMS, integrimin e databazës, testimin dhe garantimin e funksionimit teknik të saj.

Kërkesa për arsim të lartë në Informatikë, Teknologji Informacioni, Inxhinieri Informatike, Inxhinieri Telekomunikacioni ose në një profil tjetër të ngjashëm apo ekuivalent synon të sigurojë që specialisti të ketë formimin dhe njohuritë teknike të nevojshme. Diploma dhe CV-ja shërbejnë për verifikimin e formimit dhe përvojës profesionale, ndërsa kontrata e vlefshme e punës provon marrëdhënien dhe disponueshmërinë e specialistit për realizimin e kontratës.

Disponimi i specialistit deklarohet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të dokumenteve të tenderit, ndërsa dokumentet provuese paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari ose në rast se kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Kriteri mbështetet gjithashtu në Raportin Përfundimtar të Rishikuar nr. 34/34 prot., datë 06.07.2026, të hartuar nga Galeria Kombëtare e Arteve, në të cilin janë përcaktuar kërkesat për personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë Operatorit të Blerjeve të Përqendruara, të hartuara nga grupi i punës i ngritur nga titullari i autoritetit kontraktor **“Galeria Kombëtare e Arteve”**, për nevojat e së cilës Operatori i Blerjeve të Përqendruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës, zhvillon procedurën e prokurimit.

Procedura zhvillohet në emër dhe për llogari të Galerisë Kombëtare të Arteve, në zbatim të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 531, datë 07.09.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore ‘Operatori i Blerjeve të Përqendruara’ sh.a., për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë”, të ndryshuar.

Në përcaktimin e specifikimeve teknike janë marrë në konsideratë objektivat institucionale të Galerisë Kombëtare të Arteve, nevoja për konceptimin dhe zhvillimin e identitetit vizual, sistemit të komunikimit institucional, dizajnit editorial, sinjalistikës, drejtimit vizual të platformës digjitale, si dhe zhvillimit teknik të faqes web, sistemit CMS dhe implementimit teknik të komunikimit digjital.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës mbështeten në dokumentacionin teknik dhe administrativ të hartuar nga Galeria Kombëtare e Arteve, konkretisht:

Urdhri nr. 25, protokolluar me nr. 34/4 prot., datë 24.03.2026, me objekt “Për ngritjen e Komisionit për Hartimin e Termave të Referencës (Specifikimeve Teknike) dhe përlllogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt: ‘Konceptimi dhe zhvillimi i identitetit vizual, sistemit të komunikimit dhe sinjalistikës së Galerisë Kombëtare të Arteve’”;

Procesverbalin nr. 34/33 prot., datë 06.07.2026, me objekt “Mbi përlllogaritjen e fondit limit sipas loteve për procedurën e prokurimit publik me objekt: ‘Shërbim për konceptimin dhe dizajnimin e

identitetit vizual, sistemit të komunikimit, platformës digjitale dhe sinjalistikës së Galerisë Kombëtare të Arteve”;

Raportin Përfundimtar të Rishikuar nr. 34/34 prot., datë 06.07.2026, me objekt “Rishikimi i termave të referencës, specifikimeve teknike, përllogaritjes së fondit limit dhe strukturimi i procedurës në lote”;

Shkresën nr. 34/36 prot., datë 07.07.2026, me lëndë “Kërkesë për zhvillim procedure”, regjistruar pranë Operatorit të Blerjeve të Përqendruara me nr. 2868/3 prot., datë 07.07.2026.

Nëpërmjet dokumentacionit të sipërcituar, Galeria Kombëtare e Arteve ka përcaktuar natyrën dhe përmbajtjen e shërbimeve, rezultatet e pritshme, kërkesat teknike dhe funksionale, profilet profesionale të nevojshme, standardet e kërkuara, afatet e realizimit, ndarjen e objektit në lote dhe fondin limit përkatës.

Për rrjedhojë, specifikimet teknike të përfshira në dokumentet e tenderit burojnë drejtpërdrejt nga kërkesat dhe dokumentacioni i hartuar nga Galeria Kombëtare e Arteve dhe synojnë realizimin e plotë, funksional dhe cilësor të objektit të prokurimit.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë pjesë e pandarë e DST.

NJESIA E PROKURIMIT